

**AKT THEMELIMI DHE STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“DV Broadcast”**

Sot me date 26/06/2022 (Njezet e gjashte Qershori, dy mijë e njezet e dy), u mblođhen themeluesit ne adresen Rruga e Kavajes Nr 50, Coolab / Ish Volkswagen, Tirana 1002, Shqiperi, te cilet bazuar ne legjislacionin ne fuqi, ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 “Per Shoqerite Tregtare” i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014, Ligjt nr. 9723, dt.03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, Ligj Nr. 131/2015 Per Qendren Kombetare te Biznesit” ne dispozitat e Kodit Civil si dhe ne vulnetin e tyre te lire kane rene dakord per themelimin e një shoqerie me pergjegjesi te kufizuar sipas rregullimeve ne vijim:

KREU I.

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJE, SELIA

NENI 1

Emri

Emri i shoqërisë është “DV Broadcast” Sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi te kufizuar.

NENI 2

Ortaket themelues

Themeluesit e shoqerise jane:

1. Z. Gerti Dhima, shtetas shqiptar, atesia Ligor, lindur ne Fier, me 25/07/1986, madhor me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me karte identiteti me nr. Personal I60725072S
2. Z. Xhon Vrushi, shtetas shqiptar, atesia Aleksander, lindur ne Fier, me 12/02/1991, madhor me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me karte identiteti me nr. Personal J10212094K



Te cilet themelojne shoqërinë me përgjegjësi te kufizuar me emërtimin “DV Broadcast” Sh.p.k. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin në fuqi në territorin e Shqipërisë dhe dispozitat e Aktit te Themelimit dhe këtij Statuti.

### NENI 3

#### Objekti i Shoqerise

Objekti i Shoqërisë është ofrimi i sherbimeve informatike te ndryshme si vijon :

- Disenjim software-i
- Zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software
- Testim software
- Zhvillim sistemesh migrimi
- Përmirësim/upgrade sistemesh informatike;
- Operimi, menaxhimi, suporti i përdorimit, trajnimi dhe auditimi teknik/informatik për sistemet software

Gjithashtu shoqëria mund të kryejë të gjitha aktivitetet e lidhura në mënyrë direkte apo indirekte me objektin kryesor ne fushen e teknologjise se informacionit.

Shoqëria mund të blejë e të shesë kuota ose aksione në shoqëri të treta, si në mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu dhe nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj si dhe të marre pjese ne konsorciume te ndryshme me shoqëri te tjera për realizimin e aktiviteteve te përbashkëta.

Shoqëria, me vendim te organit administrativ, dhe me qellim arritjen e objektit te saj, mund te lidhe marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo ndërmarrje të tjera, si dhe të kryeje cdo veprim tregtar që organi administrativ do ta konsideroje të nevojshëm. Për këtë qellim, Shoqëria mund te lidhe marrëveshje apo kontrata qiraje, shitblerje a hipotekimi të pasurive të paluajtshme, kontrata kredie, shërbimi dhe marrëveshje a kontrata te tjera te nevojshme për ushtrimin e aktivitetit.



NENI 4

Kohezgjatja

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohe te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar.

NENI 5

Selia e Shoqërisë

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën Rruga e Kavajes Nr 50, Coolab / Ish Volkswagen, Tirana 1002, Shqiperi. Shoqëria mund të hape degë dhe/ose të krijojë filiale, si të kryejë aktivitetin e saj si brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

KREU II

KAPITALI


NENI 6

Kapitali i Regjistruar

Kapitali themeltar është 500,000 (Pese qind mijë) Lek dhe është i ndarë në 2 kuota. Kapitali themeltar është nënshkruar nga Ortaket Themelues te Shoqerise si me poshte:

1. Z. Gerti Dhima, shtetas Shqiptar, Lindur në Fier, më 25/07/1986, titullar i kartes se identitetit me nr. Personal I60725072S zoteron 1 kuote qe perben 75% te kapitalit te shoqerise, me vleren nominale 375,000 leke.
2. Z. Xhon Vrushi, shtetas Shqiptar, Lindur në Fier, më 12/02/1991, titular i kartes se identitetit me nr. Personal J10212094K zoteron 1 kuote qe perben 25% te kapitalit te shoqerise, me vleren nominale 125,000 leke.

Kontributi i ortakut mund te jetë ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/ te paluajtshme, apo te drejta)



Neni 7

### Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asne rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendimin ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 8

### Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si meposhte :

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter e parashikuar me ligj

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

### Organet Vendimmarrese



Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e per gjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) Ndryshimin e statutit
- c) Emerimin dhe shkarkimin e administratorit/administratoreve
- d) Emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjen c) e d)
- f) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratori/administratoret perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g) Miratimin e bilanceve
- h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- i) Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- j) Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorit/administratoreve
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- l) Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe maledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 10

#### Thirrja e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjene asamblese.

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "GD".

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte e thirrur sipas pikes 1 te ketij nenii, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsisë.

Neni 11

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne një shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese personalisht apo votojne me shkresë apo elektronikisht ortaket, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumica te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare", ajo mund te marre vendimete vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperm nuk arrihet, asambleja e per gjithshme, mbidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 12

Marja e Vendimeve

Asambleja e per gjithshme vendos me 3/4 e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, perceshtje te tjera.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

Neni 13

Perjashtimi nga e drejta e votes

Handwritten signatures in blue ink, likely belonging to the members of the assembly mentioned in the document.

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendimin per:

- a) Vleresimin e veprimtarise se tij
- b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria
- d) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqeshet nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 14

Administrimi

Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizik si administrator te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte riperteritje. Emerimi i administratorit/administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Administratori i Shoqërisë eshte Z. Gerti Dhima, shtetas Shqiptar, lindur ne Fier, me 25/07/1986, titullar i kartes se identitetit me nr. Personal I60725072S, banues ne Fier.

Z. Gerti Dhima ngarkohet edhe me procedurat e themelimit te shoqerise prane Qendres Kombetare te biznesit.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Gjithashtu, Administratori mund te shkarkohet ne çdo moment me vendim te Autoritetit Gjyqësor kompetent për shkelje te ligjit.

Administrimi i Shoqërisë do te kryhet nga Administratori I vetëm I cili kryen te gjitha veprimet ne lidhje me aktivitetin e zakonshëm apo te jashtëzakonshëm të Shoqërisë.



Neni 15

Kompetencat e Administratorit/Administratoreve

Administratori/ Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e objektit te shoqerisë me përjashtim te kompetencave qe ligji apo statuti ia jep shprehimisht Ortakut te Vetëm
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte dhe te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar, raportin e ecurise se veprimtarise si dhe raporte te tjera sipas keresave ligjore dhe sebashku me propozimet per shperndarjen e fitimit, i paraqesin keto dokumenta perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena te detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave te shoqerise dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te parashikuara nga ligji dhe statuti

Administratori është individualisht përgjegjës kundrejt shoqërisë dhe te tretëve për shkelje te ligjit dhe/ose Statutit.

Neni 16

Pergjegjesite e Administratorit/Administratoreve

1. Administratori eshte perjegjes individualisht ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane perjegjes per demet e sjella shoqerise dhe perjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.



2. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar te demshpermbleje shoqerine per demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta.

KREU IV  
VITI FINANCIAR- EKSPERTET  
Neni 17  
Viti Financiar

Viti finanziar fillon m date 1 Janar dhe mbyllt me date 31 Dhjetor te çdo viti. Përjashtimisht, viti I pare finanziar do te filloje nga dita e regjistrimit pranë Regjistrat Tregtar dhe do te përfundoje me 31 Dhjetor 2022.

Neni 18  
Ekspertet Kontabël

Asambleja e Pergjitheshme do te emëroje një apo me shume Eksperte Kontabël ne ato raste kur emërimi behet i nevojshëm ne baze te ligjit.

KREU V  
PRISHJA- RIORGANIZIMI I SHOQERISE  
Neni 19  
Prishja/ Likuidimi

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b) Me vendim te asamblese se ortakeve
- c) Me hapjen e procedurave te falimentimit



- d) Nese nuk zhvillon aktivitet per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar per pezullimin e veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenint 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007  
Per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- e) Me vendim gjykate

Ne rast prishje a likuidimi te shoqërisë, normat për likuidimin dhe emërimin e likuiduesve do te vendosen nga Ortaket e shoqerise ne baze te ligjit ne fuqi ne territorin e Shqipërisë.

Neni 20

Riorganizimi i Shoqerise

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

Neni 21

Klauzola mbi konfliktin e interesit

Ortaket dhe administratori/administratoret e shoqerise me perjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jene te punesuar ne nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne te njejtene fushe me te paren.

Ortaket deklarojne se krahas aktivitetit te shoqerise, ata ushtrojne aktivitet tregtar ne fushen e tekologjise se informacionit dhe si persona fizike. Ortaket deklarojne dhe pranojne se secili prej tyre do kujdeset te ruaje interesat me te mira te perbashketa te shoqerise duke ushtruar aktivitetin ne menyre te pavarur nga shoqeria dhe duke shmangur cdo konflikt te mundshem interesit qe mund te linde me te.

Ndalimi i pikes 1 mund te anullohet ne Asamblene e pare te pergjithshme me 3/4 e votave, sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shoqerite tregtare.



Neni 22

Legjislacioni

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 22

Norma te tjera


Për sa nuk parashikohet nga ky statut do te zbatohet legjislacioni ne fuqi ne territorin e Shqipërisë për shoqëritë tregtare.

Gjykata ku ka selinë shoqëria ka kompetence ekskluzive për zgjidhjen e te gjitha mosmarrëveshjeve qe mund te lindin mes ortakeve, mes këtyre dhe organeve te shoqërisë apo shoqërinë, dhe ne çdo rast kur shoqëria do te paditet ne gjykim.

Ky statut përpilohet ne katër kopje ne gjuhen shqipe dhe ne katër kopje ne gjuhen angleze me vlerë te njëjte ligjore mes tyre.

ORTAKET THEMELUES

Gerti Dhima



Xhoor Kushi

